

NDERMARRJA PUBLIKE LOKALE
N.P.L. "PASTRIMI" SH.A HANI I ELEZIT
Nr. Prot. 58/2022
Data: 22.03.2022



**NDERMARRJA PUBLIKE LOKALE PER MENAXHIMIN E
MBETURINAVE N.P.L "PASTRIMI" SH.A
HANI I ELEZIT**

STATUTI

I

**NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A.
HANI I ELEZIT**

Hani i Elezit, Mars 2022

Mbështetur në nenin 34, të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, nenin 4 dhe 34 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenin 8 dhe nenin 22 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturinat, Komisioni Komunal i Aksionareve, në mbledhjen e mbajtur më 08.03.2022 miraton:

STATUTIN

ENDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A. HANI I ELEZIT

Neni 1 Themelimi

1. Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë tregtare në Kosovë, Komisioni Komunal i Aksionarëve i komunës së Hanit të Elezit, mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës me nr.09/104 te dt.10.08.2016, themelon ndërmarrjen publike lokale për menaxhimin e mbeturinave NPL "PASTRIMI" më datë 01/11/2016.
2. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, ndërmarrjen publike lokale për menaxhimin e mbeturinave "Pastrimi" Sh.a, themelohet si shoqëri aksionare.

Neni 2 Emërtimi dhe selia

1. Emërtimi i kësaj shoqërie aksionare është: Ndërmarrja Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave "PASTRIMI" SH.A me seli në Han të Elezit.
2. Shkurtesa e emërtimit të shoqërisë aksionare në tekstin e mëtejme ndërmarrjes është NPL "PASTRIMI" SH.A.
3. Agjent i regjistruar i ndërmarrjes është Sekretari i ndërmarrjes, Samir Shkreta me vendbanim në fshatin Seçishtë me nr. personal 1175801339, i cili është agjent i ligjshëm për pranimin e shërbimeve, njoftimeve, kërkesave si dhe akteve tjera që dërgohen nga autoritetet publike.
4. Selia e ndërmarrjes është në qytetin e Hani i Elezit, rruga "Nuri Bushi".
5. Ndërmarrja mund të ushtrojë aktivitetin e saj në territorin e komunës së Hanit të Elezit dhe në territorin e Republikës së Kosovës.
6. Ndërmarrja ka ëmbelmen dhe simbolet e veta të përcaktuara me vendim të Komisionit Komunal të Aksionarëve.
7. Ndërmarrja ka vulën e vetë të rrumbullakët dhe vulën katrore, e cila përmbanë emërtimin e ndërmarrjes.

Neni 3 Statusi i ndërmarrjes

1.1. Ndërmarrja është person juridik e cila në mënyrë të pavarur paraqitet dhe ka të gjitha autorizimet në marrëdhëniet juridike me personat e tretë.

1.2. Ndërmarrja ka të drejtë të lidhkontrata dhe kryej punë tjera juridike dhe ndërmerr veprime në kuadër të aftësive të veta juridike dhe afariste.

1.3. Ndërmarrja në qarkulliminjuridik paraqitet në emër dhe llogari të vet, ndërsa për veprimet e veta përgjigjet me tërë pasurinë e vet.

Neni 4 Përfaqësitë e ndërmarrjes

Ndërmarrja sipas këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi mund të themeloj qendra, përfaqësi, degë të tjera në territorit e Republikës së Kosovës.

Neni 5 Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e ndërmarrjes është e pakufizuar, përveç nëse vendoset ndryshe nga organet drejtuese të saj.

2. Nëse kohëzgjatja e ndërmarrjes ndryshohet, duhet të njoftohet Zyra e Regjistrimit e cila e regjistron në bazën e të dhënave të saj dhe e publikon.

Neni 6 Fushëveprimtaria

1. Fushëveprimtaria e ndërmarrjes është e përcaktuar në bazë të licencës me të cilën disponon, dhe e cila ndahet në:

1.1 veprimtarinë primare: (3900) – Aktivitet e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbeturinave;

1.2 veprimtarinë sekondare: (3821) – Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme;

1.3 veprimtaritë të tjera: (3832) - Rikuperimi i materialeve të klasifikuara; (4677)-tregtia me shumicë e mbeturinave dhe hekurishteve; (8121) - pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave; (8299) – aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t.; (8411) –aktivitetet e përgjithshme të administratës publike; (9609) - aktivitetet e tjera p.k.t.

2. Ndërmarrja mund të realizoj çdo lloj operacioni financiar apo tregtar i cili lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e saj brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 7

Statuti dhe rregulloret

1. Statuti është dokument themelues i Ndërmarrjes Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave "Pastrimi "me seli në Han të Elezit i cili miratohet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve,
2. Ndryshimet dhe plotësimet në Statut, nuk kanë efekt juridik derisa të miratohen nga Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe të dorëzohen në Zyrën e Regjistrimit në përputhje me ligjin.
3. Ndërmarrja duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për menaxhimin dhe funksionimin e ndërmarrjes.
4. Rregulloret miratohen, plotësohen, ndryshohen dhe revokohen nga Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe Bordi i Drejtorëve, varësisht nga qëllimi dhe fushëveprimi i rregullores.
5. Rregulloret e miratuara mund të ndryshohen plotësohen dhe revokohen nga i njëjti organ i cili edhe ka bërë miratimin e tyre.
6. Në rast konflikti, mospërputhjes në mes statutit dhe rregulloreve, statuti i ndërmarrjes mbizotëron mbi rregulloret dhe dispozitat përkatëse të rregulloreve konsiderohen të revokuara ose të ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mospërputhjes.

Neni 8

Përgjegjësitë mbi pasurinë e ndërmarrjes

1. NPL "Pastrimi "SH.A.Hani i Elezit, është përgjegjëse për asetet dhe pasurinë e ndërmarrjes , dhe gëzon të drejtat dhe detyrimet mbi asetet dhe pasurinë e saj.

Neni 9

Kapitali themeltar dhe pasuria e ndërmarrjes

1. Kapitali themeltar i ndërmarrjes është 10,000.00 euro në pronësi 100% të Komisionit Komunal të Aksionarëve të komunës së Hanit të Elezit, ku numri i aksioneve është 10,000.00 euro, ndërsa vlera nominale është 1.00 euro.
2. Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar bëhen në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 10 Aksionet

1. Ndërmarrja do të ketë listën e aksionarëve, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
2. Aksionet e ndërmarrjes janë të formës nominale, mund të jenë të thjeshta ose e privilegjuar, të certifikuara ose të pa certifikuara, të letrave me vlerë, si dhe janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit në fuqi në Republikës së Kosovës, i cili rregullon marrëdhëniet tregtare.
3. Aksionet mund të barten dhe trashëgohen, është e lejuar bartja e një pjese të aksioneve.
4. Për bartjen e aksioneve apo një pjesë të aksioneveduhet të vendos Komisioni Komunal i Aksionarëve.
5. Aksionet e ndërmarrjes zotërohen në masën 100% nga Komisioni Komunal i Aksionareve të komunës Hani Elezit.

Neni 11 Viti financiar dhe dividenda

1. Viti financiar do të jetë i njëjtë me vitin kalendarik.
2. Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes përcakton dhe shpërndan dividendin.
3. Shpërndarja e dividendës do të bëhet vetëm me autorizim të Komisionit Komunal të Aksionarëve në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Neni 12 Organet e ndërmarrjes

1. Organet e ndërmarrjes janë:
 - 1.1. Komisioni Komunal i Aksionarëve, i cili themelohet nga Kuvendi i Komunës pas propozimit të një anëtari nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarëve nga Kuvendi Komunal;
 - 1.2. Bordi i drejtorëve -i cili zgjidhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve në përputhje me nenin 163 dhe 164 të Ligjit për Shoqëritë tregtare dhe nenit 16 dhe 17 të Ligjit për ndërmarrje publike në përbërje prej 5 anëtarëve.

1.3. Kryeshefi Ekzekutiv – i cili emërohet dhe shkarkohet në përputhje me nenin 108 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 21 të Ligjit për ndërmarrjet publike me një procedurë të hapur, transparence dhe konkurruese

Neni 13

Kompetencat e Komisionit komunal të Aksionarëve

1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë:
 - 1.1 ndryshimi dhe plotësimi i statutit ose rregulloreve të ndërmarrjes;
 - 1.2 zgjedhja ose shkarkimi i drejtorëve;
 - 1.3 autorizimi për bashkim ose transaksionet e mëdha sipas nenit 211 të Ligji për Shoqëritë Tregtare;
 - 1.4 shpërbërja e ndërmarrjes sipas nenit 229 të Ligji për Shoqëritë Tregtare;
 - 1.5 emërimi i auditorëve të pavarur të ndërmarrjes;
 - 1.6 miratimin e deklaratave financiare vjetore të ndërmarrjes; dhe
 - 1.7 çështje të tjera të rezervuara për Komisionin Komunal të Aksionarëve të përcaktuar me ligj ose me vendim në mbledhjen e përgjithshme të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Neni 14

Mbledhjet e Komisionit Komunal të Aksionarëve

1. Mbledhjet e Komisionit të Aksionarëve janë:
 - 1.1 mbledhja përgjithshme e aksionarëve;
 - 1.2 mbledhja jashtëzakonshme e aksionarëve; dhe
 - 1.3 mbledhje sipas urdhrit të Gjykatës.

Neni 15

Mbledhja e përgjithshme e Komisionit Komunal të Aksionarëve

1. Mbledhja e Përgjithshme Vjetor është pjesë e mekanizmit zyrtar të qeverisjes korporative, në të cilën Drejtorët demonstrojnë llogaridhënien e tyre tek Komisioni Komunal i Aksionarëve.
2. Në Mbledhjet e Përgjithshme shqyrtohen dhe vendosen çështjet të cilat janë në kompetencë të Komisionit Komunal të Aksionarëve.
3. Në këto mbledhje Bordi i drejtorëve duhet të propozoj zgjidhje të veçantë për secilën çështje të ndarë substanciale dhe duhet në veçanti të propozoj një zgjidhje lidhur me raportin vjetor dhe llogarit vjetore.
4. Kryesuesi duhet të aranzhoj që të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve të jenë pjesëmarrës, në veçanti ata të cilët kryesojnë Komitetet e Bordit.
5. Vendimet e mbledhjes së përgjithshme janë detyruese për ndërmarrjen dhe të gjitha organet e saj;
6. Mbledhjet e përgjithshme mbahen në javën katërt të muajit Janar të çdo viti.
7. Në Mbledhjet e jashtëzakonshme të aksionarëve dhe mbledhjet e aksionarëve sipas urdhrat të gjykatës shqyrtohen dhe vendosen çështjet të cilat gjithashtu janë në kompetencë të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Neni 16

Thirrja dhe agenda e mbledhjes së përgjithshme

1. Ndërmarrjaduhet të mbajë një Mbledhje të Përgjithshme Vjetore që të rishikojnë dhe të aprovojnë pasqyrat financiare vjetore, pas mbylljes së vitit financiar të ndërmarrjes.
2. Mbledhjet e Përgjithshme thirren nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar përmes Sekretarit.
3. Dy apo më tepër anëtarët e Bordit të Drejtorëve, apo anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve mund të kërkojnë mbajtjen e Mbledhjes së Përgjithshme.
4. Kërkesa sipas paragrafit 3 të këtij neni duhet t'i bëhet me shkrim Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, dhe duhet të aprovohet kurdo që çështjet e propozuara janë nëkompetencëtë Mbledhjes së Përgjithshme.
5. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet ta thërras Mbledhjen e Përgjithshme për një datë jo më vonë se katërdhjetë (40) ditë pasi ta ketë pranuar kërkesën, përveç nëse kërkesa përcakton një datë më të vonshme.
6. Sipas rregullave të përcaktuara çështjet shtesë mund të përfshihen në agjendën e Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore, një kërkesë e tillë mund të mos përfillet në rast se dorëzohet jo më vonë se njëqind (100) ditë pas mbylljes të vitit financiar të ndërmarrjes.

7. Nëse një kërkesë e tillë bëhet pasi të jetë dërguar njoftimi për mbledhje, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore duhet të shtyhet dhe njoftimi i ri duke përfshirë edhe çështjet shtesë të agjendës duhet të dërgohen të gjithë pjesëmarrësve.

Neni 17

Njoftimi i mbledhjes së përgjithshme dhe procedimet

1. Njoftimi për Mbledhje të Përgjithshme duhet t'i dërgohet secilit anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve, dhe secilit anëtar të Bordit të Drejtorëve, së paku tridhjetë (30) ditë më herët, njoftimi duhet të publikohet ashtu siç kërkohet me ligj.

2. Njoftimi duhet të përfshijë:

2.1. kohën dhe vendin e Mbledhjes së Përgjithshme dhe agjendën;

2.2. njoftimin se nëse ndonjë palë nuk do të jetë prezent në Mbledhjen e Përgjithshme, mbledhjamund të shtyhet për më vonë për ndonjë datë më të përshtatshme, duke përcaktuar kohën dhe vendin, një datë e tillë nuk mund të jetë më herët se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës kur ka dështuar mbledhja dhe tridhjetë (30) ditë më vonë nga data kur ka dështuar mbledhja.

3. Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme duhet të jetë në gjendje të përcaktoj identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes sëatyre që janë prezent, të udhëheqë Mbledhjen e Përgjithshme dhe duhet të përcaktoj dhe të deklaroj rezultatet e votimit.

Neni 18

Kuorumi për mbledhje të përgjithshme të Komisionit Komunal të Aksionarëve

1. Mbledhja e Përgjithshme mund të mbahet vetëm nëse ka kuorum i cili ekziston nëse dy anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve dhe 3 anëtarët e Bordit të Drejtorëve janë prezent në mbledhje.

2. Sekretari duhet të kryej aranzhimet e nevojshme që anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve të jenë në Mbledhjen e Përgjithshme.

3. Nëse nuk ka kuorum për brenda një periudhe të arsyeshme kohore pas kohës së përcaktuar për fillim, Mbledhja e Përgjithshme duhet të ndërpritet apo të shtyhet për një datë të përshtatshme që është e përcaktuar në njoftim.

4. Nëse në Mbledhjen e Përgjithshme të shtyrë nuk ka kuorum brenda një periudhe të arsyeshme kohore, Mbledhja e Përgjithshme do të anulohet.

Neni 19

Udhëheqësi i mbledhjes së përgjithshme

1. Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme caktohet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve i cili duhet që duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë statut, të konstatoj prezencën e kuorumit, të drejton debatin dhe të mbaj procesverbalin dhe konstatoj rezultatet e votimit.

2. Sekretari i ndërmarrjes do tëndihmoj udhëheqësin në organizimin dhe mbajtjen e mbledhjes .

Neni 20 Votimi

1. Një vendim i vënë në votim në Mbledhjen e Përgjithshme duhet të vendoset nga numërimi, i cili fillon menjëherë kur udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme udhëzon, duke numëruar votat për dhe kundër vendimit.

2. Në rast se ka votim të barabartë udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme (nëse ai apo ajo është anëtar i KKA-së) mund të ketë votë vendimtare.

3. Mbledhja e Përgjithshme mund të miratoj vetëm vendimet në lidhje me çështjet të cilat janë vendosur në agjendë e mbledhjes.

4. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve do të ketë fuqi dhe prodhoj efekte.

Neni 21 Aksionarët

1. Në përputhje me nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Komisioni Komunal i Aksionarëve, ushtron të drejtat të aksionarit në emër të komunës për ndërmarrjet publike lokale.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve është i themeluar me vendim të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit.

Neni 22 Bordi i Drejtorëve

1. Biznesi dhe veprimtaria e ndërmarrjes do të drejtohet nga Bordi i Drejtorëve, si organ ekzekutiv i ndërmarrjes , siç është përcaktuar në këtë statut dhe ligj.

2. Bordi i Drejtorëve zgjidhet në përputhje me nenin 163 dhe 164 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 16 dhe 17 të Ligjit për ndërmarrje publike.

Neni 23 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve

1. Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve përbëhet prej 4 anëtarëve, si në vijim:

2.

Emri dhe mbiemri	Pozita	Vendbanimi	Nr. Personal
2.1 <u>Albulena Ballazhi</u>	Kryesues e Bordit;	Hani i Elezit	
	Rr.Veterant e Uçk		1172472474
2.2 <u>Nazmi Suma</u> ,	Anëtar i Bordit;	Hani i Elezit	
Rr. Adem Jashari			1030790789
2.3 <u>Fahri Bushi</u> ,	Anëtar i Bordit;	Hani i Elezit	
Rr. Izet Bushi			1004505766
2.4 <u>Laura Bushi</u> ,	Anëtare e Bordit;	Hani i Elezit	
Rr. Lidhja e Prizrenit			1232070516

Neni 24

Kompetencat e Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve ka këto kompetenca:
 - 1.1. menaxhimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes;
 - 1.2. marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet e veprimtarisë së ndërmarrjes, përveç vendimeve të cilat u janë rezervuar aksionarëve me ligj ose me statutin e ndërmarrjes;
 - 1.3. miratimine planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike të ndërmarrjes;
 - 1.4. përgatitjen dhe organizimine mbledhjeve të përgjithshme dhe të jashtëzakonshme të Komisionit Komunal të Aksionarëve;
 - 1.5. Punësimine zyrtarëve/menaxherëve të lartë të ndërmarrjes, përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendëve;
 - 1.6. Miratimine raportit vjetor të ndërmarrjes, raportit të bilancit vjetor dhe vlerësimeve vjetore të fitimeve dhe të humbjeve të cilat pastaj do të dorëzohen tek Komisioni Komunal i Aksionarëve për miratim.
 - 1.7. përgatitjen e agjendës fillestare të mbledhjes së Komisionit Komunal të Aksionarëve;
 - 1.8. përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendës;
 - 1.9. miratimin e raportit vjetor të ndërmarrjes dhe vlerësimin vjetor të fitimit dhe humbjeve të cilat pastaj dorëzohen tek Komisioni Komunal i Aksionarëve për miratim.
 - 1.10.përcaktimin,transaksionet financiare me propozim të Kryeshefit Ekzekutiv(KE), për të cilat KEnuk do të ketë fuqinë të veproj (dhe të obligoj

ndërmarrjen) në mënyrë të pavarur por duhet të kërkoj autorizim paraprak nga KE apo nga Bordi i Drejtorëve;

1.11.sigurimin e sistemeve adekuate të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat se a janë vendosur në vendin e duhur;

1.12.të siguroj se auditimi i librave dhe regjistrave kryhet të paktën çdo vit nga auditori i jashtëm;

1.13.të siguroj që biznesi i ndërmarrjes nuk devijon nga qëllimi i deklaruar në statut pa autorizimin e qartë të Mbledhjes së Përgjithshme;

1.14.të nxjerr direktiva për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe me propozim të KE të cakton zyrtarë të tjerë (përveç KE, ZKF, Sekretari dhe Zyrtari për Auditim të Brendshëm), duke vendosur përgjegjësitë, detyrat dhe rregullat e tyre në lidhje me emërimin, kompensimin, largimin apo zëvendësimin e tyre.

Neni 25 **Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve**

1. Bordi i Drejtorëve mbanë mbledhje të rregullta dymujore, mbledhjen vjetore si dhe mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme.
2. Njoftimi për mbledhje duhet të ketë agjendën dhe duhet të dorëzohet, së paku tre ditë para mbledhjes.
3. Në raste të emergjencës, njoftimi për mbledhjen duhet të dërgohet së paku një ditë para mbledhjes.
4. Në mbledhje, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë Statut, duhet të përcaktoj praninë e kuorumit, të drejtë debatin, si dhe të mbajë procesverbalin dhe të përcaktoj dhe deklarojë rezultatet e votimit.
5. Mbledhjet e Bordit udhëhiqen nga Kryesuesi dhe mund të mbahen nëse për këtë plotësohet kuorumi prej 2/3 e përbërjes së Bordit.
6. Vendimet merren me shumicë të votave të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Neni 26 **Aktivitetet e tjera të bordit të drejtorëve**

1. Përveç nëse me statut ose rregullore të ndërmarrjes kërkohet që një aktivitet i Bordit të ndërmerret ekskluzivisht në mbledhje të Bordit, të gjitha aktivitetet të cilat mund të ndërmerren në mbledhje të Bordit mund të ndërmerren edhe pa mbajtjen e mbledhjes, nëse pëlqimi për aktivitetet e tilla nënshkruhet nga të gjithë drejtorët me të drejtë vote për atë çështje.

2. Pëlqimet duhet të vendosen në procesverbal dhe hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga të gjithë drejtorët, përveç nëse në pëlqim është caktuar një datë tjetër e hyrjes në fuqi.

Neni 27

Raportet e Bordit të Drejtorëve

Pas çdo takimi të Bordit të Drejtorëve, do të përgatitet një raport i cili përmban një përmbledhje të vendimeve më të rëndësishme dhe rezolutave të arritura në mbledhje, duke i fshehur vetëm ato informata në lidhje me të cilat nevojitet konfidencialiteti arsyeshëm, informata të tilla do të përfshihen në raportet e më vonshme kur më nuk ekziston nevoja për të ruajtur konfidencialitetin.

Neni 28

Komisioni i auditimit

1. Komisioni i Auditimit formohet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe përbëhet prej tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, dy prej tyre duhet të kenë njohuri në kontabilitet.
2. Kryeshefi Ekzekutiv dhe Kryesuesi i Bordit nuk mund të jenë anëtar të Komisionit të Auditimit.
3. Funkcionet dhe kompetencat e Komisionit të auditimit janë të përcaktuara me nenin 24, 25 dhe 26 të Ligji nr. 03/L-087 Mbi Ndërmarrjet Publike.

Neni 29

Komisionet e Bordit

1. Bordi i Drejtorëve, me rregullore, përcakton kur mund të miratoj themelimin e një ose më shumë komisioneve, (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve), që do të shqyrtoj, hulumtoj, rekomandoj ndonjë çështje për Bordin.
2. Në komisione mund të përfshihen edhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe punëtorët e ndërmarrjes dhe persona jashtë ndërmarrjes sipas përcaktimit në rregullore.
3. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Bordit.

Neni 30

Kryeshefi Ekzekutiv

1. Kryeshefi Ekzekutiv (KE) emërohet dhe shkarkohet në përputhje me nenin 108 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 06/L-016 dhe nenit 21 të Ligjit për ndërmarrjet publike me një procedurë të hapur, transparence dhe konkurruese.

Kryeshefi Ekzekutiv është zgjedhur **Hirman Kuka** me Komuna - Hani i Elezit me nr. personal 1012249086.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv, janë:

2.1. udhëheqë ndërmarrjen, harton dhe rekomandon planet strategjike tek Bordi që do të sigurojnë rritjen fitimprurëse të ndërmarrjes dhe arritjen e objektivave të biznesit të saj;

2.2. menaxhon me burimet njerëzore dhe financiare të ndërmarrjes në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse në fuqi;

2.3. organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit ;

2.4. analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;

2.5. menaxhon me punët e përditshme të ndërmarrjes gjatë veprimtarisë së saj;

2.6. përfaqëson interesat e ndërmarrjes gjatë veprimtarisë së saj dhe është përgjegjës në përmbylljen e të gjitha transaksioneve në emër të ndërmarrjes;

2.7. udhëzon zyrtarët e tjerë të ndërmarrjes me qëllim të kryerjes së detyrave në mënyrë efikase dhe në përputhshmëri me legjislacionin dhe statutin e ndërmarrjes;

2.8. nënshkruan marrëveshje ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së zakonshme të përditshme të ndërmarrjes;

2.9. siguron përgatitjen dhe mbajtjen e librave, kontabilitetit dhe arkivin e ndërmarrjes në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe siguron qasje për Bordin e Drejtorëve dhe anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve;

2.10. përgatit raportin financiar dhe menaxhues të ndërmarrjes të cilin i dorëzon bordit të drejtorëve të ndërmarrjes;

2.11. mbështet punën e Bordit të Drejtorëve përmes këshillave dhe informatave lidhur me veprimtarinë e ndërmarrjes;

2.12. është përgjegjës për shërbimet që ofron ndërmarrja dhe zbatimin e vendimeve dhe politikave të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit Komunal të Aksionarëve.

3. Kryeshefi Ekzekutiv duhet të veproj me mirëbesim dhe përherë në interes të ndërmarrjes dhe duke shmangur konfliktin e interesit.

Neni 31
Zyrtarët e lartë të ndërmarrjes

1. Në bazë të nenit 21.3 ndërmarrja duhet t'i këtë këta zyrtar të lartë:
 - 1.1 Zyrtarin kryesor financiar (ZKF);
 - 1.2 Zyrtarin i auditimit të brendshëm (ZAB);
 - 1.3 Sekretarin; dhe
 - 1.4 Zyrtarë tjerë të cilat mund të caktohen nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 32
Zyrtari Kryesor Financiar

1. Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) emërohet dhe shkarkohet në përputhje me nenin 21 të Ligjit për ndërmarrjet publike me një procedurë të hapur, transparence dhe konkurruese.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kryesor Financiar, janë:
 - 2.1. planifikon dhe përgatit propozim buxhetin vjetor të ndërmarrjes;
 - 2.2. udhëheq, organizon dhe koordinon punët financiare, konform ligjeve, rregullave dhe akteve normative;
 - 2.3. siguron zbatimin e politikave financiare të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve;
 - 2.4. përgatit planin e të hyrave të përgjithshme të ndërmarrjes dhe shpërndarjen, shpenzimin e tyre;
 - 2.5. mbikëqyrë të hyrat dhe shpenzimet financiare të ndërmarrjes dhe udhëzon për menaxhimin e tyre;
 - 2.6. merr pjesë në hartimin e planit të biznesit të ndërmarrjes;
 - 2.7. kujdeset për zbatimin e planit unik të kontabilitetit dhe jep udhëzime për ndryshim dhe plotësim të planit kontabël në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit;
 - 2.8. përgatit raporte periodike financiare dhe sipas kërkesës së Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
3. Zyrtari Kryesor Financiar për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Neni 33
Sekretari

1. Sekretari i ndërmarrjes emërohet dhe shkarkohet në përputhje me nenin 21 të Ligjit për ndërmarrjet publike me një procedurë të hapur, transparence dhe konkurruese.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit janë:

- 2.1. përgatit dhe koordinon të gjitha aktivitetet rreth mbledhjeve të rregullta dhe jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve;
- 2.2. siguron të dhëna, raporte dhe prezantime për mbledhjet e përgjithshme të Komisionit Komunal të Aksionarëve dhe të Bordit të Drejtorëve;
- 2.3. kujdeset që vendimet për ndërmarrjen të jenë në përputhje me ligjet përkatëse në fuqi;
- 2.4. është përgjegjës për regjistrimin e të dhënave dhe veprimeve në mbledhjet e aksionarëve dhe Bordit të Drejtorëve në një libër që mbahet për këtë qëllim;
- 2.5. menaxhon me dokumentet, kontratat e punëtorëve, përshkrimin e vendeve të punës dhe përfaqëson ndërmarrjen, në kontestet gjyqësore dhe kontestet tjera;
- 2.6. mbanë procesverbalet e takimeve dhe shpërndan procesverbalet tek Drejtorët e Bordit dhe Komisioni Komunal i Aksionarëve;
- 2.7. kujdeset për formën e unifikuar të akteve komunikuese të brendshëm dhe jashtë ndërmarrjes dhe mirëmban, përditëson web faqen e ndërmarrjes;
- 2.8. bënë ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave, dokumenteve të ndërmarrjes, publikon ato për autoritetet përkatëse siç kërkohet me ligjin për ndërmarrjet publike ose statuti i ndërmarrjes;
- 2.9. përgatit raporte periodike dhe sipas kërkesës së Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

3. Sekretari i ndërmarrjes për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Neni 34

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm

1. Zyrtari i Auditimit të Brendshëm emërohet dhe shkarkohet në përputhje me nenin 21 të Ligjit për ndërmarrjet publike me një procedurë të hapur, transparence dhe konkurruese.
2. Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit Zyrtari i Auditimit të Brendshëm i ndërmarrjes kryen këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 2.1 udhëheq të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm, përfshirë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
 - 2.2 harton planin e auditimit të brendshëm për të gjitha transaksionet e ndërmarrjes, komform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të bazuara në legjislacionin e aplikueshëm;

- 2.3 ofron vlerësime të pavarura dhe objektive për veprimtaritë financiare dhe operative të ndërmarrjes për udhëheqësin e saj.
- 2.4 përgatit raportin e auditimit për çështjet që janë duke u audituar, përfshirë rekomandimet për përmirësime;
- 2.5 monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe inicion veprime korigjuese aty ku është e nevojshme;
- 2.6 bënë auditimin e pasqyrave vjetore të bilancit dhe deklaratat e të hyrave dhe shpenzimeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj;
- 2.7 verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë që librat dhe dokumentacioni i ndërmarrjes, përfshirë edhe dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me legjislacionin në fuqi;
- 2.8 përgatit dhe dorëzon raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit tek udhëheqësi i institucionit dhe Komisioni për Auditim të Brendshëm;
3. Zyrta i Auditimit të Brendshëm për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Komisionit të Auditim ndërsa në aspektin administrativ Kryeshefit Ekzekutiv .

Neni 35

Detyrat në mirëbesim

1. Çdo drejtor dhe zyrtar i ndërmarrjes gjatë kryerjes së detyrave në ndërmarrje duhet:
- 1.1 të veprojnë në mirëbesim për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të aksionaritgjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;
- 1.2 të ushtrojnëfuqinë që iu është dhënë atyre ekskluzivisht në përputhje me interesat më të mira të ndërmarrjes;
- 1.3 të kenë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e tyre;
- 1.4 të shmang dhe shpalos konfliktet e tanishme dhe potenciale në mes të interesave të tyre personale (direkte apo indirekte) dhe të interesave të ndërmarrjes;
- 1.5 të ushtroj kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre;
- 1.6 të trajtoj si konfidenciale të gjitha informatat të pranuar me arsye nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre.

Neni 36

Konflikti i interesave

Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit rregullisht, së paku çdo tre muaj, do të lëshojnë një raport të shkurtër të përbashkët, me një gjuhë të qartë që nxjerr në pah të gjitha rastet në të cilat cilido Drejtor apo Zyrtar ka deklaruar ekzistimin e konfliktit potencial të interesave dhe ka abstenuar nga votimi ose nga veprimi, duke dhënë indikacione për natyrën e interesave dhe vendimet vepruese për shkak të cilave janë ngritur ato. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahet nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të ndërmarrjes dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e më vonshme kur më nuk eksiton nevoja për konfidencialitet, në asnjë rrethanë informacioni nuk mund të mbahet për shkak të interesave të Drejtorit apo Zyrtarit përkatës.

Neni 37

Transaksionet me palët e ndërlidhura

Komisioni i Auditimit rregullisht sëpaku çdo tre muaj do të lëshojnë një raport të shkurtër dhe përmbajtësor, duke nxjerr në pah transaksionet më të rëndësishme me palët e ndërlidhura të cilat nuk i ka miratuar, duke dhënë arsyet për mos miratimin e tyre dhe të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura që i ka miratuar duke paraqitur vlerën e transaksioneve; vlerën e bilanceve të papaguara, duke përfshirë kushtet, dhe garancionet; provizionet për borxhet e dyshimta lidhur me vlerën e bilanceve të papaguara, dhe shpenzimet e pranuar gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija (të papagueshme) apo të dyshimta të caktuara nga palët përkatëse të ndërlidhura si dhe deklarata se kjo e fundit ka qenë e arsyeshme dhe e drejtë për ndërmarrjen.

Neni 38

Promovimi i transparencës përmes faqes zyrtare në internet

1. Ndërmarrjato të krijoj dhe në mënyrë të rregullt do të azhurnoj nën përgjegjësinë e Kryeshefit Ekzekutiv një web faqe ku do të paraqiten së paku këto informacione:

1.1 dokumentet zyrtare të ndërmarrjes; që parashihen dhe raportet nga Komisioni i Auditimit;

1.2 raporti nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare që parashihen me ligjin e ndërmarrjeve publike;

1.3 listën e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur gjatë vitit aktual financiar që tregojnë natyrën e tyre, çmimin dhe palët tjera;

1.4 listën e të gjitha kontratave të prokurimit të lidhura gjatë vitit aktual financiar pa ndjekur procedurat e tenderimit, duke treguar për natyrën e tyre, çmimin, palët tjera dhe arsyen pse procedurat e tenderimit nuk janë përcjell;

1.5 listën e dhjetë (10) furnizuesve më të rëndësishëm të ndërmarrjes me çmimet e furnizimeve;

1.6 çfarëdo padie në gjyq, rasti në arbitrazh (me kushtin e mos shkeljes së konfidencialitetit) apo rastet në pritje në lidhje me vlefshmërinë e çfarë do zgjedhjeje të drejtorit, shkelje të detyrave të mirëbesimit të drejtorëve apo zyrtarëve apo vlefshmëria e çfarë do vendimi të miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve;

1.7 të gjitha informatat dhe dokumentet e tilla do të shpërndahen në paragrafët e ndarë dhe në mënyrë të lehtë për t'iu qasur, me lidhje tek dokumentet tjera kurdo që të jetë e nevojshme dhe do të përfshihet në një paragrafë të vetëm të web faqes e cila i dedikohet shpalosjeve publike për çështjet e korporatës dhe do të vendosët në një mënyrë të thjeshtë dhe që mund të lexohet lehtë.

Neni 39

Detyrimi për mos konkurrencë

1. Zyrtarët dhe drejtorët nuk mund të jenë të përfshirë në konkurrencë tregtare kundër ndërmarrjes, e cila përfshinë por nuk kufizohet vetëm në punësimin, të qenit ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor ose anëtar kontrollues ose aksionar në ndonjë ndërmarrjetjetër tregtare që ushtron aktivitete tregtare konkurruese.
2. Nëse anëtari i ndërmarrjes vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni , ndërmarrja mundet të kërkoj kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Neni 40

Ushtrimi i detyrimeve sipas vendimit personal ose të gjykatës

1. Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të paraqes ankesë në gjykatë në emrin e ndërmarrjes kundër një ose më shumë drejtorëve ose zyrtarëve, nëse ka arsye të mira për të besuar sa zyrtarët dhe drejtorët përkatës kanë shkelur detyrimet ndaj ndërmarrjes dhe me këtë e kanë dëmtuar ndërmarrjen.
2. Ankesat e paraqitura duhet të përshkruajnë në hollësi përpjekjet që janë bërë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve për ta shtyrë Bordin e Drejtorëve që ta paraqesë ankesën në emër të ndërmarrjes ose një deklaratë se këto përpjekje nuk janë bërë për shkak se me siguri se do të kishin qenë të padobishme së bashku me një deklaratë ku paraqiten arsyet për mbështetjen e kësaj deklarate.
3. Nëse Komisioni Komunal i Aksionarëve është i suksesshëm në këtë rast, të gjitha kompensimet e dhëna dhe të pranuar janë pronë e ndërmarrjes, përveçse Komisioni Komunal i Aksionarëveka të drejtë që t'i mbulojnë shpenzimet e tyre të arsyeshme, duke përfshirë tarifatat ligjore nga pala mbrojtëse.

Neni 41

Rezervat dhe pasuria e ndërmarrjes

1. Ndërmarrja është e obliguar që të krijoj rezervat detyrueshme, për të cilat kujdeset Bordi i Drejtorëve.
2. Në rezervat obligative futen 5% e fitimit deri sa rezervat nuk arrijnë lartësinë 10% të kapitalit themeltar. Pas arritjes së asaj lartësie, rezervat obligative duhet të qëndrojnë në atë nivel.
3. Vendimin për rezerva tjera eventuale të ndërmarrjes të cilat do të formoheshin me ndarjen nga fitimi, e nxjerr Komisioni Komunal i Aksionarëve, nëse vlerëson që rezervat e tilla janë të nevojshme.
4. Pasurinë e ndërmarrjes e përbëjnë e drejta e pronësisë në sendet e luajtshme dhe paluajtshme, mjetet financiare dhe letrat me vlerë si dhe të drejtat e tjera pronësore.

Neni 42 Të punësuarit

1. Vendimet mbi pranimin dhe ndërprerjen e angazhimit të zyrtarëve të lartë për nevojat e ndërmarrjes i bën Bordi i Drejtorëve.
2. Vendimet mbi pranimin dhe ndërprerjen e angazhimit të punëtorëve si dhe personave tjerë për nevojat e ndërmarrjes e bën Kryeshefi Ekzekutiv me konsultimi paraprak me Bordin e Drejtorëve.
3. Në qeverisjen e ndërmarrjes, pjesëmarrjen në fitim dhe realizimin e të drejtave tjera nga marrëdhënia e punës, të punësuarit gëzojnë të drejtat e përcaktuara me ligj dhe me aktet normative të ndërmarrjes.

Neni 43 Shpërbërja e ndërmarrjes

1. Ndërmarrja është themeluar për kohë të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet vetëm në rastet dhe mënyrën e përcaktuar me ligj dhe këtë statut.
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve në emër të komunës vendos mbi shpërbërjen ndërmarrjes, vendimi nxirret në formë të dokumentit të shkruar publik dhe zhvillohet procedura e përcaktuar e likuidimit.
3. Shpërndarja e ndërmarrjes bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për likuidimin e shoqërive aksionare.

Neni 44 Çështjet te cilat nuk janë të rregulluara me statut

Për te gjitha çështjet te cilat nuk janë te rregulluara me këtë Statut, aplikohendrejtpërsëdrejtidispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet publike dhe të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Çështjet te cilat nuk janë të rregulluara me statut

Për te gjitha çështjet te cilat nuk janë te rregulluara me këtë Statut, aplikohendrejt përsëdrejt dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet publike dhe të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 45

Plotësimi dhe ndryshimi i statutit

Statuti i miratuar mund të ndryshohet dhe plotësohet nga i njëjti organ i cili edhe ka bërë miratimin e tij.

Neni 46

Hyrja në fuqi

Ky statut hynë në fuqi 8, (tetë) ditë pas miratimit nga Komisioni i Aksionarëve dhe regjistrimit në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Hani i Elezit,
10/03/2022

Komisioni Komunal i Aksionarëve

Sevime Bajrami, kryesues
Sherif Berisha, anëtarë
Xhevair Dernjani, anëtarë



